



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Komisionereve



### *VENDIM*

*Nr. 9 Datë 06.02.2014*

### *MBI*

### ***NJË SHITESË NE “RREGULLOREN MBI PROCEDURAT E EMËRIMIT TE ADMINISTRATORIT DHE KOMPETENCAT E TIJ, NE ZBATIM TE NENIT 18, PIKA 4/C TE LIGJIT NR. 9072, DATE 22.05.2003 “PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”***

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “l”, dhe 18, pika 4 gërma “c” të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.02.2014, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, lidhur me një shtesë në “Rregulloren mbi Procedurat e Emërimit të Administratorit dhe Kompetencat e Tij, në zbatim të nenit 18, pika 4 gërma “c”, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”,

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

### *Vendosi:*

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 150, datë 30.12.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Mbi prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, që nuk mbulohet nga prokurimi vjetor.”
2. Të shtojë në nenin 12 pika 4, të Rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij në zbatim të nenit 18, pika 4 gërma “c”, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, paragrafin me përmbajtjen si më poshtë :

*CEZ Shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm, për nevoja të mbulimit të plotë të humbjeve në sistemin e shpërndarjes, të realizojë blerjet e energjisë elektrike mbi baza mujore për sasinë e energjisë elektrike që nuk mbulohet nga prokurimi vjetor. Për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes mbi baza mujore, Administratori zbaton Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me Nr. 30, datë 23.03.2011, “Për miratimin e Rregullave dhe Procedurave të Blerjes së Energjisë Elektrike nga KESH sh.a”.*

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë OSSH sh.a për vendimmarrjen e ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Komisionerëve



*Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për*

***VENDIMIN***

***Nr. 9 Datë 06.02.2014***

***MBI***

***NJË SHITESË NE “RREGULLOREN MBI PROCEDURAT E EMËRIMIT  
TE ADMINISTRATORIT DHE KOMPETENCAT E TIJ, NE ZBATIM TE  
NENIT 18, PIKA 4/C TE LIGJIT NR. 9072, DATE 22.05.2003 “PËR  
SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”***

**Anëtarët e Bordit**

	<b>Pro</b>	<b>Kundër</b>
<b>Petrit Ahmeti</b>	_____	_____
<b>Adriatik Bego</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____